

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“TIRANA TOWER” sh.p.k

Sot në Tiranë, më **21.05.2024**, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “*Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “*Për Tregtarët dhe Shoqërítë Tregtare*”, i ndryshuar dhe në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”, i ndryshuar:

Shoqëria **“ANCHOR INVESTMENTS” sh.p.k.**, shoqëri e të drejtës shqiptare, me seli në Tiranë, Rruga “*Ibrahim Rugova*”, Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019, regjistruar në Q.K.B., me NIPT: **L71421016I**, përfaqësuar nga administratori z. **Albi SHYTI**, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal J11110084P,

themelon Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të quajtur **“TIRANA TOWER” sh.p.k.**

Neni 1
Emërtimi

Në kuptim të këtij Akt - Themelimi, Ortak të kësaj Shoqërie është Shoqëria **“ANCHOR INVESTMENTS” sh.p.k.**, shoqëri e të drejtës shqiptare, me seli në Tiranë, Rruga “*Ibrahim Rugova*”, Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019, regjistruar në Q.K.B., me NIPT: **L71421016I**, përfaqësuar nga Administratori z. **Albi SHYTI**, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal J11110084P,

Neni 2
Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do jetë si në vijim:

“Objekti parësor i veprimtarisë së shoqërisë është projektimi, ndërtimi, vënia në shfrytëzim, si dhe çdo lloj shërbimi apo aktiviteti tregtar, investimi, ndërtimi, financiar, kreditimi, konsulencë, ndërmjetësimi, sipërmarrje, nënkontraktimi, bashkëpunimi, qiradhënie, i një strukture banimi dhe shërbimi të ndodhur në Rrugën “*Xhanfizë Keko*”, Bashkia Tiranë, e quajtur “Tirana Tower”. Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtaritë tjetër plotësuese që lidhet direkt ose indirekt me realizimin e projekteve Tirana Tower. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose blejë/përfitojë direkt ose indirekt pjesëmarrje, në shoqëri, ndërmarrje, agjenci apo sipërmarrje të tjera, të cilat kanë fushë veprimtarie të ngjashme. Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, material ndërtimor, si dhe çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbytjes së objektit të Shoqërisë. Gjithashtu, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj shërbimi apo aktiviteti që i lejohet një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë së saj”.

Neni 3
Selia

3.1 Zyra qëndrore e Shoqërisë ndodhet në adresën Tiranë, Rruga “Ibrahim Rugova”, Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019.

3.2 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, në respekt të parashikimeve ligjore ne fuqi si edhe të Statutit, përveç aktivitetit në nivel lokal, do të mund të hapen dhe të mbyllen seli dytësore, stabilimente, filiale, zyra përfaqësimi, agjensi dhe adresa brenda dhe jashtë territorit Shqiptar.

3.3 Selia mund të transferohet në çdo vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 4
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.

**Neni 5
Kapitali**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 Lekë (dhjetë mijë lekë) dhe përbëhet nga 1 (një) kuotë.

5.2 Pjesëmarrja e Ortakut Themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij si më poshtë:

Nr.	Emri	Numri i kuotave	Pjesëmarrja në përqindje (%)	Vlera totale e kontributit (Lekë)
1.	Anchor Investments sh.p.k	1	100%	10.000

**Neni 6
Emërimi i Administratorit**

Emërohet Administrator i Vetëm për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare, duke filluar nga dita e regjistrimit të Shoqërisë, **Z. Enrik FILTO**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 30.05.1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim me nr. personal I10530067T.

**Neni 7
Legjislacioni i Referimit**

Për gjithçka nuk është parashikuar nga ky Akt-Themelimi do t'i bëhet referim legjislacionit shqiptar në fuqi në lidhje me shoqëritë tregtare.

**Neni 8
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**


Kompetencë ekskluzive mbi të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Ortakëve dhe organeve të vetë Shoqërisë do të ketë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë .

**Neni 9
Vula e Shoqërisë**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me tekstin rreth saj.

**Neni 10
Gjuha e Akt - Themelimit**

Ky Akt - Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqiptare.



Neni 11
Dispozita të Fundit

11.1 Shoqëria TIRANA TOWER sh.p.k. do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe të këtij Akt - Themelimi.

11.2 Ky Akt - Themelimi nënshkruhet nga Ortaku Themelues më datë **21.05.2024** pasi është lexuar, kuptuar dhe konform vullnetit të shprehur të tij.

ORTAKU THEMELUES
Shoqëria ANCHOR INVESTMENTS sh.p.k.

Administratori

z. Albi SHYTI

